



**GARË NË 3, 6 DHE 9 ME PENGESA.
REKOMANDIMI ËSHTË SIGURUAR,
ÇKA NË TË ARDHME?**

Monitorimi i zbatimit të tre muajve
të fundit nga Plani 3-6-9

Maj 2018

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer dhe Institutit për demokraci “Societas Civilis” - Shkup

IMPRESUM

Titulli: Garë në 3, 6 dhe 9 me pengesa. Rekomandimi është siguruar, çka në të ardhme?
Monitorimi i zbatimit të tre muajve të fundit nga Plani 3-6-9

Botues: Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë,
Instituti për demokraci „Societas Civilis“ - Shkup

Autor: Zoran Neçev në bashkëpunim me Ivan Nikollovski

Përkthyes: Mustafa Peza

Dizajn dhe përgaditje: Vladimir Barlakoski

Publikimi mund të shkarkohet falas në linkun në vijim:

<http://www.kas.de/mazedonien/>

<http://www.idscs.org.mk>

GARA NË 3, 6 DHE 9 ME PENGESA

*Rekomandimi është siguruar, çka në të ardhme?
Monitorimi i zbatimit të tre muajve të fundit nga Plani 3-6-9*

*“You are free to choose, but you are not free to
alter the consequences of your decisions”¹*

Ezra Taft Benson

Autor: Zoran Neçev në bashkëpunim me Ivan Nikolovskin.

Qëllimi është arritur, çka mëtutje?

Më 17 prill, Komisioni Evropian Republikës së Maqedonisë i ndau rekomandim të pakushtëzuar për fillim të negociatave për anëtarësim, me atë duke i rekomanduar Këshillit të Evropës që të propozojë datë për fillim të bisedimeve paraqasëse.² Në fjalimet e veta para medieve të Maqedonisë, Përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe të sigurisë dhe nënkryetare e Komisionit Evropian, Federika Mogerini, dhe komisarja për politikë fqinjësore Evropiane dhe negociata për zgjerim, Johanes Han, e lëvduan kthyerjen e Maqedonisë në rrugën evropiane duke i uruar Qeverisë dhe opozitës për këtë sukses bashkërisht të arritur.³ Me marrjen e rekomandimit për fillimin e bisedimeve qasëse, plani i jashtëzakonshëm

për prioritete urgjente reformuese, Plani 3-6-9, e arriti qëllimin e vet primar.

Prapëseprapë, përkundër përkushtimit dhe vullnetit politik të demonstruar në përmbushjen e agjendës reformuese përmes miratimit të ligjeve, strategjive dhe masave të nevojshme,⁴ me rëndësi qenësore është implementimin e tyre praktik.⁵

Ajo që gjithashtu është me rëndësi kyç për eurointegrimet e Republikës së Maqedonisë është koordinimi më efikas dhe më efektiv i proceseve reformuese.⁶ Për këtë shkak, në

1 Je i lirë të zgjedhësh, por nuk je i lirë ti ndryshosh pasojat nga zgjedhja jote (përkthim i lirë).
2 Komisioni Evropian, „Raport për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018 (dokument punues),” European Commission, 17-ët prill i vitit 2018. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
3 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Pres konferencë e përbashkët e kryeministrit Zaev dhe përfaqësueses së lartë të UE, Mogerini, 18 prill i vitit 2018. <https://www.youtube.com/watch?v=zOBsF3XuAyY>.

4 Komisioni Evropian, „Raport për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018 (dokument punues),” European Commission, 17-ët prill i vitit 2018, fq. 4. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

5 Komisioni Evropian, „Raport për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018 (dokument punues),” European Commission, 17-ët prill i vitit 2018, fq. 10. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

6 Komisioni Evropian, „Raport për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018 (dokument punues),” European Commission, 17-ët prill i vitit 2018, fq. 13. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

të ardhmen duhet të mendohet për gjetje të mekanizmit përkatës për monitorim të përmbushjes së proceseve reformuese,

posaçërisht për shkak të faktit që para shtetit qëndron shumë punë në statet e ardhshme të procesit eurointegrues. Kjo kërkon përkushtim pa kompromise të pushtetit, por edhe të opozitës dhe të gjitha faktorëve shoqëroro-politik të prekur të cilët të bashkuar, çdonjëri nga perspektiva e vet, duhet të punojnë për implementimin e kriterëve për anëtarësi fuqiplote në Unionin.

Në atë drejtim, në përpilimin e „Planit 18”⁷ të paralajmëruar, të kyqur duhet të jenë të gjithë akterët shoqëror dhe politik relevant, dhe i njëjti duhet të parashehë formë adekuate të monitorimit të proceseve reformuese. Për më shumë në linjë me qasjen e re të Komisionit për udhëheqjen e negociatave për zgjerim, ky plan duhet të fokusohet në reformat nga fusha e sundimit të të drejtës, me qëllim të mbajtjes së “kontinuitetit” dhe “thellimit” të proceseve të filluara.⁸

Bëhet fjalë për ato fusha të cilat janë të përfshira në prioritetet urgjente reformuese dhe rekomandimet e Pribes nga vitet 2015 dhe 2017. Ka nevojë që plani i ri të jetë i konceptuar në mënyrë që i njëjti tërësisht do t’i adresojë

reformat e rekomanduara të cilat i përmbajnë këto tre dokumente, posaçërisht duke i pasur parasysh se prej gjithsej 130 aktiviteteve të parapara në planin 3-6-9, 66 aktivitete (51%) i adresojnë rekomandimet nga raportet e Pribes dhe/ose prioritetet urgjente reformuese. Ndërsa 16 aktivitete (12%) adresojnë Programin nacional për adoptimin e legjislativit të Unionit Evropian (NPAA 2016 – 2018 dhe aneksin i tij 2017 – 2020).⁹

Përveç kësaj, si një vend që po pret një datë për hapjen e negociatave, përveç këtyre fushave prioritare të planit 3-6-9, duhet të fillojë skicimin e reformave gjithëpërfshirëse dhe ndërtimin e kapaciteteve në pjesë të tjera të legjislacionit evropian. Marrja e rekomandimit pozitiv do të thotë fitim i kohë më të gjatë për implementimin e reformave qenësore për të cilat është e nevojshme periudhë më e gjatë kohore. Kjo është me rëndësi për shkak të faktit që ekziston nevojë për ngritje të cilësisë së reformave përmes analizës së thelluar dhe miratimit të politikave të bazuara në dëshmi. Raporti i sivjetëm për Maqedoninë, si dhe komentet e Komisionarit Han gjatë vizitës në Maqedoni, e vë në pah praktikën e keqe të përdorimit të shpeshtë të procedurës së shkurtuar ose urgjente të miratimit të ligjeve dhe politika të cilat negativisht reflektohen në cilësinë e tyre¹⁰.

Nga kjo, plani i ri duhet t’i kushtojë vëmendje cilësisë së politikave reformuese, por edhe mënyrës së miratimit të tyre, ndërsa në drejtim të krijimit të politikave dhe të miratimit të vendimeve në pajtim me parimet e transparencës, llogaridhënies, inkluzionit dhe sundimit të mirë.

7 „Qeveria e Republikës së Maqedonisë, „Zëvendës kryeministri Bujar Osmani prezantoi raportin për realizimin e Planit 3-6-9,” Qeveria e Republikës së Maqedonisë 13 prill i vitit 2018. <http://vlada.mk/node/14445> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018); Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Konferencë e përbashkët e kryeministrit Zoran Zaev dhe eurokomisarit Johannes Han, 18 prill i vitit 2018. <https://www.youtube.com/watch?v=bEIN6zq-Pbo> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018); Jasminka Pavlovska, „Plani 18 për datë në qershor”, Nova Makedonija, 21 prill, 2018 e qasshme këtu: <https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d0%bd-18-%d0%b7%d0%b0-%d0%b4%d0%b0%d1%82%d1%83%d0%bc-%d0%b2%d0%be-%d1%98%d1%83%d0%bd%d0%b8/> (për herë e fundit e qasur më 23.04.2018).

8 Komisioni Evropian, „Raport për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018 (dokument punues),” European Commission, 17-ët prill i vitit 2018, fq. 13. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

9 Përkundër asaj që plani i tërësishtëm përmban 130 masa, lëndë e kodimit janë 129 masa për shkak të faktit që aktiviteti “revidim i Ligjit për azil” në pjesën 3 dhe aktiviteti “miratimi i Ligjit për mbrojtje ndërkombëtare dhe të përkohshme” në pjesën 9, kanë të bëjnë me të njëjtin ligj përkatësisht masë.

10 Komisioni Evropian, „Raport për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018 (dokument punues),” European Commission, 17-ët prill i vitit 2018, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018),,

Një udhëzues i mirë për konceptimin dhe strukturimin e këtij plani të ardhshëm janë planet e veprimit për implementimin e përcaktuesve të kapitujve 23 dhe 24 në rastin e pranimit të Serbisë dhe Malit të Zi në BE.¹¹ Të njëjtit ofrojnë një afat kohor të detajuar për aktivitetet, por edhe dhe kompetencat e përcaktuara qartë të institucioneve përkatëse dhe të bartësve të funksioneve. Krahas kësaj, janë identifikuar treguesit e suksesit, me çka do të shmangen situatat e një qasjeje metodologjike të ndryshme për vlerësimin e suksesit të reformave nga faktorë të ndryshëm shoqëroro-politik.

Nga pikëpamja politike, Maqedonia duhet të vazhdojë me tendencën pozitive të ndërhyrjeve reformuese në bashkëpunim me opozitën parlamentare dhe aktorët e tjerë të interesuar. Vetëm portofoli i pastër dhe harmonizimi për rëndësinë e reformave thelbësore në vend, mund t'i ndihmojë Maqedonisë ta ruajë rekomandimin e pastër, t'i bind vendet -anëtare skeptike se Maqedonia ka kapacitet demokratik dhe administrativ që t'i udhëheq negociatat dhe të ketë situatë të pastër në negociatat me Greqinë për tejkalimin e dallimeve rreth emrit.

Ky raport ndërlihet me serinë e raporteve për monitorim të zbatimit të Planit 3-6-9, të njohur nën titullin "Gara 3, 6 dhe 9 me pengesa". Monitorimi i zbatimit të masave zhvillohet sipas metodologjisë paraprakisht të përcaktuar e cila është në aneksin ndaj këtij raporti.

Gjatë përpilimit të këtij raporti, por edhe si mbështetje e hulumtimit dhe të të dhënave të paraqitura, janë konsultuar shkrime gazetareske, hulumtime paraprake dhe dokumente qeveritare.

11 Republika e Serbisë, grupi negociator për Kapitullin 23 (projekt), prill 2015. <https://www.mpravde.gov.rs/files/Action%20Plan%20Ch%2023%20Third%20draft%2020.04.2015..pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018); Qeveria e Malit të Zi, „Plan aksionar për Kapitullin 23: „Gjyqësia dhe të drejtat fundamentale“, 27 qershor i vitit 2013. <http://www.gov.me/ResourceManager/FileDownload.aspx?rid=146815&rType=2&file=AP%2023%20ENG.doc>. (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

Realizimi pjesërisht i suksesshëm i pjesës 9

Në këtë kapitull janë prezantuar gjetjet nga monitorimi i zbatimit të masave të parapara në pjesën 9.

Përcjellja e zbatimit të pjesës 9 nga plani 3-6-9 të Institutit për demokraci "Societas civilis" zbulon se nga gjithsej 26 aktiviteteve të parapara,¹² 8 aktivitete (31%) janë të përmbushura, 2 aktivitete (8%) janë të pjesërisht të përmbushura, 11 aktivitete janë të pa përmbushura (42%), ndërsa 5 aktivitete (19%), janë aktivitete të pamatshme. Pjesa 9 ka të bëjë me periudhën nga fillimi i vitit deri më 17 prill të vitit 2018 – datës së shpalljes së raportit të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018.¹³ Krahasimi me pjesët 3¹⁴ dhe 6¹⁵ është i prezantuar në tabelën e vendosur më poshtë.


12 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, „Plani 3-6-9+“, 15 nëntor i vitit 2017. <http://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/%D0%9D%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%B5%D0%BD%20%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D0%BD%206-9%20%28MK%29.pdf>. (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

13 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, „Reformat nga Planit 3-6-9 rrrumbullakësohet më 17 prill dhe i përshpejtojnë proceset integruese për Republikën e Maqedonisë në UE dhe në NATO“, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 31 mars i vitit 2018. <http://vlada.mk/node/14365> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

14 Zoran Neçev dhe Ivan Nikollovski, „Gara në 3, 6 dhe 9 me pengesa: Monitorim i zbatimit të tre muajve të para nga Planit 3-6-9“, Instituti për demokraci „Societas civilis“ - Shkup, nëntor 2017.

15 Zoran Neçev dhe Ivan Nikollovski, „Gara në 3, 6 dhe 9 me pengesa: Monitorim i zbatimit të tre muajve të para nga Planit 3-6-9“, Instituti për demokraci „Societas civilis“ - Shkup, shkurt 2018.

Tabela 1. Krahasimi i statusit të realizimit të pjesëve 3, 6 dhe 9



Vërejtje: Vlerat e prezantuara në këtë tabelë paraqesin përqindje të aktiviteteve të plotësuara, pjesërisht të plotësuara, të pa përmbyshura dhe të pamatshme.


Duke e pasur parasysh shifrat e paraqitura më lartë, konkluzioni është se nga i tërë plani pjesa 9 shënon status më të ulët të realizimit të aktiviteteve krahasuar me pjesët paraprake duke e pasur parasysh përqindjen e aktiviteteve të plotësuara që është më i ulët deri tani. Kështu, pjesa 9 shënon 10% më pak aktivitete të përmbyshura në raport me pjesën 3 dhe mbi 20% aktivitete më pak të përmbyshura në raport me pjesën 6. Nga ana tjetër, numri i aktiviteteve të pa përmbyshura për nga ana komparativ është më i madh dhe ka të bëjë me pothuajse gjysmën e masave të parapara në këtë pjesë. Për nga ana statistikore, përqindja më e lartë nga aktivitetet e papërmbyshura u takon ligjeve reformuese sistemore në pjesën e jurisprudencës për miratimin e të cilave është e nevojshme përkrahje edhe nga opozita. Duke pasur parasysh se opozita e botoi punën e Kuvendit në pjesën më të madhe të kohës të parapare për pjesën 9, statusi i këtyre të realizimit nuk do të duhej të vjen si befasi.

Aktivitetet e pamatshme janë gjithashtu në rritje të butë. Shembuj për llojin e tillë të aktiviteteve janë edhe "vazhdimi i punës së grupit

punues për reforma të Kuvendit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes së pranueshme politike për ndryshim të Rregullores dhe fuqizimin e kapaciteteve vetanake të Kuvendit" në fushën "Kuvendi". Të tilla janë edhe aktivitetet të cilat parashikojnë emërim të personave udhëheqës dhe të organeve mbikëqyrës në fushën "Emërimet" – aktivitete të cilat nuk vënë në pah se për cilat persona udhëheqës përkatësisht këshilla udhëheqës dhe mbikëqyrës kanë të bëjnë emërimet përkatëse. Të vendosura në mënyrë të këtillë, këto aktivitete nuk mund në mënyrë precize të maten.

Sa i përket përqindjes së rekomandimeve të adresuara nga raporti i Pribes dhe/ose prioritetet urgjente reformuese të Komisionit Evropian, aktivitetet në pjesën 9 në masë më të vogël i adresojnë këto rekomandime nga pjesët 3 dhe 6. Nga ana tjetër, pjesa 9 qëndron më lartë se sa pjesët 6 dhe 3 në raport me harmonizimin e masave me Programin Nacional për adoptimin e legjislativit të Unionit Evropian (NPAA 2016 - 2018 dhe aneksi i saj 2017 - 2020). Krahasimi i pjesëve 3, 6 dhe 9 në raport me këto çështje është prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Krahasimi i harmonizimit të masave në pjesët 3, 6 dhe 9 me rekomandimet nga raportet e Pribes, prioritetet urgjente reformuese dhe NPAA



Vërejtje: Vlerat e prezantuara në këtë tabelë paraqesin përqindje të aktiviteteve të masave nga Plani 3-6-9 të cilat janë të harmonizuara me rekomandimet nga raportet e Pribes, prioritetet urgjente reformuese dhe NPAA.

Për në fund, duke pasur parasysh faktin se pjesët 6 dhe 9 juprezantuan publikut në të njëjtën kohë, mbetet e njëjta konkluzë si në pjesën 6 se ka përmirësim në parashikueshmërisë të aktiviteteve. Gjithashtu mbetet konkluzioni se është bërë prioritetizimi përkatës i fushave të reformave dhe aktiviteteve që ato i përmbajnë. Kjo është e dukshme përmes faktit që plani e vë theksin mbi reformat në gjyqësinë, sigurinë e zbulimit, si dhe në administratën publike.

Konteksti politik – konflikt iluzor, marrëveshje prapa skenës dhe shmangie të përgjegjësisë?

Ky kapitull jep një vështrim të kontekstit politik gjatë realizimit të pjesës 9.

Njëlloj si edhe në rastin e pjesës 6, gjatë periudhës kohore të cilën e mbulon pjesa 9, puna e Kuvendit u bojkotua nga partia më e

madhe opozitare VMRO-DPMNE. Në të njëjtën kohë, kjo periudhë gjithashtu ishte e shënuar me akuza të ndërsjella për frenimin e proceseve reformuese. Pushteti e akuzonte opozitën për mos pasje të konstruktivitetit, papërgjegjësi dhe vënie të interesave partiake para atyre shtetërore për shkak të mos-pjesëmarrjes së saj në miratimin e ligjeve reformuese për të cilat është e nevojshme shumicë prej dy të tretat. Kështu, Qeveria e bënte përpjekje ta bind publikun se gjithçka që ishte në juridiksionin e saj u përmbush, duke e zhvendosur fajin për vonesën në zbatimin e veprimtarive në opozitën dhe bllokadën e saj të Parlamentit.¹⁶ Nga ana tjetër, opozita fe fajësonte Qeverinë për mos përmbushjen e premtimeve të saj, paaftësinë për implementimin e reformave, partizimin e institucioneve dhe mos respektimin

¹⁶ Radio Evropa e Lirë, „Osmani: Vonohen ligjet reformuese për shkak të bllokadës së Kuvendit“, Radio Evropa e Lirë, 21 mars i vitit 2018. <https://www.slobodnaevropa.mk/a/29113796.html> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

e parimit të sundimit të ligjit.¹⁷ Këtu është me rëndësi të thuhet se opozita e bojkotoi punën e Parlamentit sipas nevojës, duke u kthyer vetëm në tavolina parlamentare, sipas tyre, për nevojën për “mbrojtje të interesave kombëtare”, gjë e cila, nga ana e vet krijon përshtypje se një qasje e tillë e tyre nuk mbështetet në baza parimore dhe zë sinqerta. Në të vërtetë, një nga interesat kryesore kombëtare që nga pavarësia e këndeje, në të gjitha qeveritë e mëparshme është pikërisht anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

Përplasja mes qeverisë dhe opozitës arriti kulmin në 14 mars të vitit 2018 - ditën kur Kuvendi e votoi për herë të dytë Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Shumica në pushtet vendosi ta miratojë Ligjin edhe përkundër vërejtjeve të opinionit të ekspertëve lidhur me kushtetutshmërinë e tij, theksimit të krerëve të BE se nuk është një ligj me prioritet,¹⁸ kritikën ndaj keqpërdorimit të procedurës me flamurin evropian dhe rrezikun që e njëjta ta sjell nën pikëpyetje rekomandimin pozitiv për negociatën,¹⁹ kritikën e shoqërisë civile për mungesën e analizës gjatë hartimit të saj,²⁰

17 VMRO-DPMNE, „Ministria e drejtësisë nuk kreu asgjë brenda 10 muajve“, [www.a1on.mk](https://a1on.mk/archives/874619), 1 Prill i vitit 2018. <https://a1on.mk/archives/874619> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

18 Faktor, „Zhbogar: Ligji i gjuhëve nuk është prioritet evropian“, Faktor Portal, 24 mars i vitit 2018. <https://faktor.mk/zbogar-zakonot-za-jazici-ne-e-evropski-prioritet> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

19 Goran Mihajlovski, „Rekomandimi për UE qëndron pezull për shkak të mënyrës në të cilën është miratuar Ligji për gjuhët, thotë ambasadori francez Timonie“. Dëshiroj të them, 15 mars i vitit. <https://sdk.mk/index.php/makedonija/preporakata-za-eu-visi-poradi-nachinot-na-koj-e-donesen-zakonot-za-jazitsite-veli-frantsuskiot-ambasador-timonie/> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

20 Instituti për demokraci „Societas Civilis“ - Shkup, „Rrjeti për legjislativ më të mirë: Reagim publik rreth mos-përgatitjes së PVR për Ligjin për përdorim të gjuhëve“, Instituti për demokraci „Societas Civilis“ - Shkup, 26 janar, 2018. <http://idscs.org.mk/mk/2018/01/26/%d0%bc%d1%80%d0%b5%d0%b6%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%be%d0%b4%d0%be%d0%b1%d1%80%d0%b0-%d0%bb%d0%b5%d0%b3%d0%b8%d1%81%d0%bb%d0%b0%d1%82%d0%b8%d0%b2%d0%b0-j% d 0 % b 0 % d 0 % b 2 % d 0 % b d % d 0 % b 0 - %d1%80%d0%b5%d0%b0/> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

gjithashtu duke i lënë anësh me atë rast 35000 amendamentet e parashtruara të opozitës. Fati i ligjit aktualisht është i panjohur dhe mund të paraqesë burim të problemeve në të ardhmen. Për të njëjtin duhet të gjendet një zgjidhje dhe një dalje nga vakuumi ekzistues në të cilin është futur. E njëjta gjë mund të bëhet vetëm në bashkëpunim me Presidentin e shtetit dhe në një mënyrë të denjë për një shtet demokratik i cili e pret fillimin e negociatave me UE.

Nga ana tjetër, një pjesë e medieve spekuluan se pushteti dhe opozita në realitet bashkëpunojnë prapa dyerve të mbyllura, veçanërisht për një pako të ligjeve reformuese. Këto spekulime u konfirmuan më vonë nga Kryeministri Zoran Zaev dhe udhëheqësi VMRO-DPMNE Hristijan Mickovski, pas përfundimit të njërit prej takimeve të liderëve.²¹ Aq më tepër, në raportin faktografik për realizimin e planit në disa vende përmendet pjesëmarrja e opozitës, ndërsa në vetë hyrjen e raportit është shënuar se “(n)ë definimin e masave kontribut të vetin kanë dhënë shërbimet profesionale të të gjitha institucioneve kompetente, Kuvendi, Qeveria, institucionet shtetërore, sektori civil dhe opozita”.²² Së fundmi, vetëm pak ditë nga afati përfundimtar për realizimin e planit, më 17 prill, opozita u kthye në Parlament dhe e mbështeti miratimin e Ligjit për Agjencinë Operacionale - Teknike dhe Ligjin për ndjekjen e komunikimeve – që të dy si pjesë e paketës së ligjeve reformuese. Gjithashtu ekziston edhe një njoftim se ligjet e tjera do të miratohen gjatë muajit maj, me një votim pozitiv nga opozita. Një vendosje e tillë e lojtarëve kryesorë politik e krijon përshtypjen se konflikti i tyre i ndërsjellë është në të vërtetë një iluzion. Për fat të keq, “përplasja” e tillë krijoi polarizim shtesë në shoqërinë tashmë të polarizuar, në raport me çështjet e rëndësishme

21 Press 24, “Ligjet reformuese të harmonizuara - pritet që vetëm deputetët e VMRO – DPMNE-së të dalin nga paraburgimi”, [press24.mk](http://www.press24.mk/reformskite-zakoni-usoglaseni-se-cheka-samo-pratenicite-na-vmro-dpmne-da-izlezat-od-pritvor), 5 mars i vitit 2018. <http://www.press24.mk/reformskite-zakoni-usoglaseni-se-cheka-samo-pratenicite-na-vmro-dpmne-da-izlezat-od-pritvor> (për herë të fundit qasur më 24.04.2018).

22 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, “Raport faktografik për implementimin e: Planit 3-6-9 nga 4 korriku i vitit 2017 - 17 prill 2018,” fq 4, Sekretariati për çështje evropiane, prill i vitit 2018.

të ndërlidhura me procesin e eurointegrimi të Republikës së Maqedonisë. Kjo praktikë është e paqëndrueshme, pasi ka të bëjë me çështje të interesit nacional që kanë të bëjnë me procesin e integritimit në BE, për të cilin të gjitha grupet parlamentare e përkrahën Deklaratën në Kuvendin në kuadër të pjesës 3 nga plani 3-6-9.

Edhe përkundër lëvdatave të Komisionit Evropian për punën që iu drejtuan në adresë të pushtetit dhe opozitës, sjellja e këtillë e të dyja palëve, për fat të keq, është një tregues i deficitit demokratik të partive politike dhe një nivel i ulët i përgjegjësisë në qasjen ndaj implementimit të prioritetëve reformuese – kyç për zhbllokimin e procesit eurointegruar të Maqedonisë dhe ndërtimin e një konsensusi politik dhe shoqëror për zgjidhjen e kontestit të emrit. Suksesi i një Qeverie në procesin e anëtarësimit në UE konsiston edhe në atë e njëjta të ruajë dhe kultivojë bashkëpunim të mirë me pjesët e tjera të pushtetit, por edhe me opozitën, ndërsa përgjegjësia për mos-zbatimin e një pjese të konsiderueshme të masave të parapara në pjesën 9 duhet të ndahet, e jo të bëhen vërejtje dhe të shmanget. Përveç kësaj, është e nevojshme të identifikohen problemet reale që e kanë sjellë këtë gjendje. Nga ana tjetër, opozita me mos pjesëmarrjen e saj në proceset reformuese nuk kontribuoi për përshpejtimin e aspiratave evropiane të vendit.

Realizimi i kënaqshëm i Planit 3-6-9

Kjo pjesë e raportit i bën vështrim statusit të zbatimit të Planit 3-6-9 në tërësi.

Duke iu referuar statusit të zbatimit të planit të përgjithshëm,²³ rezultatet janë ato që

vijojnë: nga gjithsej 130 aktivitete,²⁴ 78 aktivitete (60%) janë të plotësuara, 7 aktivitete (6%) janë pjesërisht të plotësuara, 14 aktivitete janë të pa përmbushura (11%), ndërsa 30 aktivitete janë të pamatshme (23%). Duke e pasur parasysh kontekstin kohor dhe politik të miratimit të Planit të veprimit 3-6-9, por edhe sfidat politike brenda dhe jashtë shtetit gjatë realizimit të tij, ajo që mund të konkludohet se plani ka një status të kënaqshëm të realizimit.

Më tutje, analiza jonë tregon se 66 aktivitete (51%) i adresojnë rekomandimet nga raporti i Prbesë dhe dhe/ose prioritet urgjente reformuese, ndërsa 16 (12%) nga masat tregojnë harmonizim me NPAA dhe/ose me ankesin e saj. Konkluzioni nga kjo është se plani kënaqshëm i ndjek rekomandimet e Pribes dhe prioritetet urgjente reformuese, ndërsa vërehet harmonizimi i ulët me NPAA - një dokument strategjik kyç, që i përfshin prioritetet, dinamikën e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë evropian, si dhe përshtatjen e institucioneve kombëtare me strukturat administrative evropiane.

Ajo që prapëseprapë është patjetër e nevojshme të përmendet është se pothuajse në të gjitha pjesët e planit ekzistojnë aktivitete që janë të realizuara pas përfundimit të afatit të paraparë kohor të pjesëve të caktuara. Përveç kësaj, mbresëlënëse ishin edhe mosmarrëveshjet rreth përfshirjes së masave të Planit 3-6-9 Gjegjesisht, në versionet fillestare të planit, më saktësisht Planit për prioritetet urgjente reformuese 3-6-9 që i referohet nenit 3²⁵ dhe plani përshkrues për pjesët 6 dhe 9 (Plani

23 Realizimi i planit në tërësi ka të bëjë me periudhën nga 04.07.2017 deri më 17.04.2018 duke mos i marrë parasysh afatet kohore për pjesë të veçanta nga plani.

24 Kjo shifër nuk i përfshin dy aktivitete të prezantuara në Planin 3-6-9+ të cilat janë të konceptuara si të vazhdueshme. Në monitorimin e implementimit të masave nuk është marrë parasysh aktiviteti "Miratimi i Ligjit për mbrojtje ndërkombëtare dhe të përkohshme" në pjesën 9 për shkak të ngjashmërisë me aktivitetin "revidimi i Ligjit për azil" në pjesën 3.

25 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, "Raport faktografik për implementimin e: Planit 3-6-9 nga 4 korriku i vitit 2017. <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

3-6-9+) ²⁶ gjithsej ishin të parapara 130 masa (73 në pjesën 3 plus 57 aktivitetet në pjesët 6 dhe 9, duke mos e përfshirë angazhimin deklarativ për përmbushjen e Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe dy aktivitetet e vazhdueshme). Nga ana tjetër, në konferencën për shtyp në të cilën u prezantua realizimi i planit të përgjithshëm, zëvendëskryeministri i Qeverisë i obliguar për çështje evropiane, z. Bujar Osmani, iu referua 103 masave nga plani. ²⁷

Për më tepër, edhe në konferencën për shtyp të Osmanit edhe në raportin e detajuar faktografik, u referua për aktivitetet që fillimisht nuk ishin të përfshira me pjesët 3, 6 dhe 9. Shembuj të tillë janë miratimi i propozim-Ligjit për ndihmë të lirë, emërimi i Udhëheqësit të shërbimit sprovues, mbajtja e evidencës për zbatimin e rekomandimeve nga Komiteti kundër torturës të Këshillit të Evropës dhe shumë të tjera. ²⁸ I vendosur në këtë mënyrë, raporti i detajuar faktografik krijon situatë e cila krijon huti të panevojshme tek publiku.

Me mësimin nga gabimet: ndaj bashkëpunimit të përkushtuar, shtrimin e dorës dhe hartimin e planit të ri reformues

Ajo që mund të nxirret si përfundim nga ky raport është se qëllimi kryesor i planit të reformës 3-6-9, marrja e një rekomandimi të pastër për fillimin e negociatave për anëtarësim është arritur. Republika e Maqedonisë është ndarë si shembulli (më) pozitiv, procesi i çlirimit të shtetit është në një rrugë të sigurt, ndërsa hapërimi drejt anëtarësimit të plotë më në fund është rikthyer në rrugën e duhur.

Edhe përkundër dhënies së përparësisë së duhur agjendës reformuese në pjesën 9, i njëjti shënon një status pjesërisht të kënaqshëm të zbatimit. Një nga arsyet për gjendjen e këtillë është mungesa e përgjegjësisë të pushtetit, por edhe te opozita në lidhje me miratimin e dokumenteve kyç reformuese për shkyçjen e procesit eurointegruar të Republikës së Maqedonisë.

Plani arrin një shkallë të kënaqshme të përmbushjes së masave që është 60%. Plani i adreson në nivel të lartë rekomandimet e Pribes dhe/ose prioritetet urgjente reformuese, ndërsa tregon nivel të ulët me NPAA dhe/ose aneksin e saj. Për më tepër, ajo që mund të vërehet se ka një mosmarrëveshje rreth vëllimit të masave të parashikuara me planin, ndërsa në raportin të detajuar faktografik për zbatimin e tij janë të përfshira masat që nuk ishin parashikuar fillimisht me versionet e botuara në fillim.

Duke i pasur parasysh këto vërejtje, por edhe nevojën për të vazhduar, ruajtur dhe thelluar procesin reformues, me rëndësi kyç është gjithashtu e rëndësishme hartimi i një plani të ri reformues që do të ishte hartuar në bashkëpunim me të gjithë palët e prekura dhe aktorët relevantë shoqëroro - politik. Një plan i tillë duhet të strukturohet në mënyrë

26 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, „Plani 3-6-9+“, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 15 nëntor i vitit 2017. <http://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/%D0%9D%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%B5%D0%BD%20%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D0%BD%206-9%20%28MK%29.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018)

27 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, „Zëvendës kryeministri Bujar Osmani e prezantoi raportin për realizimin e Planit 3-6-9“, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 13 prill, 2018. <http://vlada.mk/node/14445> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018)

28 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, „Raport faktografik për implementimin e: Planit 3-6-9 nga 4 korriku i vitit 2017, Sekretariati për çështje evropiane, prill i vitit 2018. <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/faktografskiizveshtajplan369.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).

të qartë, duke parashikuar një kornizë kohore të detajuar, kompetenca të përcaktuara rreptësisht dhe kriteret të performancës. I njëjti duhet ti adresojë plotësisht rekomandimet e Pribes dhe prioritetet urgjente reformuese, por edhe vërejtjet dhe rekomandimet e raportit më të fundit për Republikën e Maqedonisë, veçanërisht lidhur me nevojën për zbatimin e duhur të legjislacionit të miratuar, por gjithashtu edhe cilësinë dhe mënyrën e krijimit të politikave. Gjatë hartimit të këtij plani nevojitet që të mbahet llogari për harmonizimin e tij me NPAA dhe Planin 3-6-9.

Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në UE është një prioritet i lartë i vendit dhe i njëjti kërkon një qasje shtetërore, veçanërisht në periudhën vijuese. Gjetja e zgjidhjes së çështjes së emrit paraqet sfidë dhe ngarkesa më e madhe në procesin për praninë në UE. Prandaj, në periudhën e hapjes së mundësive si rezultat i intensifikimit të negociatave me Greqinë, Maqedonia ka nevojë për një dosje të qartë në përmbushjen e prioritetëve të reformës dhe kriteret për anëtarësim. Prandaj, pikërisht për këtë hallka më e rëndësishme e këtij procesi afatgjatë është demonstrimi i pjekurisë politike, përgjegjësisë dhe bashkëpunimit të të gjithë aktorëve shoqëroro - politik, e parësisht të shumicës dhe opozitës.

Aneks ndaj raportit

Metodologji sipas së cilës përcillet implementimi i Planit 3-6-9

Plotësimi i aktiviteteve monitorohet përmes përcaktimit të treguesve të vet dhe në disa raste edhe të nën-treguesve. Matja e statusit të përmbushjes së aktiviteteve do të bëhet sipas logjikës së mëposhtme:

1. Të zbatuara;

2. Pjesërisht e zbatuara (në vazhdë e sipër);

3. Të pa zbatuara;

4) E pamatshme/nuk mund të përcaktohet. Mënyra e tillë e monitorimit rrjedh nga vetë natyra dhe mënyra në të cilën përcaktohen aktivitetet në Planin.

Të zbatuara:

Si të zbatuara konsiderohen ato aktivitete treguesit e të cilave vënë në pah tregojnë se aktiviteti i parashikuar është plotësuar brenda afatit kohor prej 3 muajsh, përkatësisht përfundimisht me zgjedhjet lokale.

Pjesërisht të zbatuara (në vazhdë e sipër): Për pjesërisht të zbatuara janë ato aktivitete, treguesit dhe nën-treguesit e të cilave janë të përmbushura pjesërisht; vetëm një nga treguesit është përmbushur (në rast të më shumë treguesve); ose treguesit janë plotësuar, por jo edhe nën-treguesit.

E pa zbatuar: Si të pa zbatuara do të konsiderohen ato aktivitete treguesit dhe nën-treguesit e të cilave vënë në pah se aktiviteti i parashikuar nuk është plotësuar brenda afatit të përcaktuar kohor.

Nuk mund të përcaktohet: Për aktivitetet statusi i të cilave të përmbushjes nuk do të mund të përcaktohet konsiderohen ato aktivitete për të cilat nuk ka burim të besueshëm se janë zbatuar, se janë të pa zbatuara ose të zbatuara pjesërisht; aktivitetet që duhet të riformulohen për të përcaktuar treguesit; aktivitete që për nga natyra janë përgjegjësi e institucionit kompetent, si dhe aktivitete që nuk janë të matshme për nga natyra.

Gjatë përcaktimit të statusit të përmbushjes (zbatimit) për secilën nga aktivitetet ekziston një burim, i cili shërben si provë dhe përkrahje se kodimi i të njëjtit është kryer në përputhje me udhëzimet e parapara metodologjike.

Bibliografia

Burime të shtypura

- Neçev Zoran dhe Ivan Nikolovski. "Gara 3, 6 dhe 9 me pengesa. Drejtë një rekomandimi të pastër? Monitorimi i zbatimit të tre muajve të dyta të Planit 3-6-9". Instituti për demokraci Societas Civilis - Shkup, shkurt i vitit 2018.
- ————. "Gara 3, 6 dhe 9 me pengesa: Monitorimi i zbatimit të tre muajve të para nga Plani 3-6-9." Instituti për demokraci Societas Civilis - Shkup, nëntor i vitit 2017.

Burime elektronike

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë. "Zëvendëskryeministri Bujar Osmani prezantoi raportin për realizimin e Planit 3-6-9." Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 13 prill 2018. <http://vlada.mk/node/14445> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- ————. Konferencë e përbashkët për shtyp e Kryeministrit Zaev dhe Përfaqësueses së Lartë të UE Mogherini, 18 prill 2018. <https://www.youtube.com/watch?v=z0BsF3XuAyY> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- ————. Konferencë e përbashkët për shtyp e Kryeministrit Zoran Zaev dhe Komisionerit të BE Johannes Hahn, 18 prill 2018. <https://www.youtube.com/watch?v=bEIN6zq-Pbo> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- ————. "Plani 3-6-9." Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 4 korrik 2017. <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- ————. "Plani 3-6-9 +, "15 nëntor 2017. <http://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/%D0%9D%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%B5%D0%BD%20%D0%BF%D0%B-%D0%B0%D0%BD%206-9%20%28MK%29.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- ————. "Reformat nga Plani 3-6-9 rumbullakosen më 17 prill dhe i përshpejtojnë proceset integruese për Republikën e Maqedonisë në UE dhe NATO." Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 31 mars 2018. <http://vlada.mk/node/14365> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- ————. "Raporti faktografik mbi zbatimin e: Planit 3-6-9 nga 4 korriku të vitit 2017. - 17 prill 2018" Sekretariati për Çështje Evropiane, prill 2018. <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/faktografskiizveshtajplan369.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- Qeveria e Malit të Zi. "Plani i Veprimit për Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore", 27 qershor 2013". <http://www.gov.me/Resource-Manager/FileDownload.aspx?rid=146815&rType=2&file=AP%2023%20ENG.doc> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- VMRO-DPMNE. "Ministria e Drejtësisë nuk ka bërë asgjë për 10 muaj." www.a1on.mk, 1 prill 2018. <https://a1on.mk/archives/874619> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- Komisioni Evropian. "Raport për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018 (dokumenti i punës)." European Commission, 17 prill, 2018. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. "Rrjeti më i mirë Legjislacioni: Një reagim publik ndaj dështimit për të përgatitur PVR për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve". Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup, 26 janar 2018. <http://idscs.org.mk/mk/2018/01/26/%d0%bc%d1%80%d0%b5%d0%b6%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%be%d0%b4%d0%be%d0%b1%d1%80%d0%b0-%d0%bb%d0%b5%d0%b3%d0%b8%d1%81%d0%bb%d0%b0%d1%82%d0%b8%d0%b2%d0%b0-j%d0%b0%d0%b2%d0%b-d%d0%b0-%d1%80%d0%b5%d0%b0/>.
- Mihailovski, Goran. "Rekomandimi për BE qëndron pezull nga mënyra se si miratuar Ligji për gjuhët, thotë ambasadori francez Timonie." Dëshiroj të them, 15 mars 2018. <https://sdk.mk/index.php/makedonija/preporakata-za-eu-visi-poradi-nachinot-na-koj-e-donesen-zakono-t-za-jazitsite-veli-frantsuskiot-ambasador-timonie/> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- Pavlovska, Jasminka. "Plani 18 për një datë në qershor." Nova Makedonia, 21 prill 2018. <https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d0%bd-18-%d0%b7%d0%b0-%d0%b4%d0%b0%d1%82%d1%83%d0%bc-%d0%b2%d0%be-%d1%98%d1%83%d0%bd%d0%b8/> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- Radio Evropa e Lirë. "Osmani: Vonohen ligjet reformuese për shkak të bllokimit të Kuvendit". Radio Evropa e Lirë, 21 mars 2018. <https://www.slobodnaevropa.mk/a/29113796.html> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- Republika e Serbisë, grupi negociator për Kapitullin 23. "Plani i veprimit për Kapitullin 23 (Projekt)", prill 2015. <https://www.mpravde.gov.rs/files/Action%20Plan%20Ch%2023%20Third%20draft%2020.04.2015..pdf> (последен пат пристапено на 23.04.2018).
- Faktor. "Zhbogar: Ligji për gjuhët nuk prioritet evropian". Faktor Portal, 24 mars i vitit 2018. <https://faktor.mkzbgogar-zakonot-za-jazi-ci-ne-e-evropski-prioritet> (për herë të fundit qasur më 23.04.2018).
- Press 24. "Ligjet reformuese të harmonizuara - Pritet vetëm deputetët e VMRO - DPMNE-së të dalinn nga paraburgimi". [press24.mk](http://www.press24.mk/reformskite-zakoni-usoglaseni-se-cheka-samo-pratenicite-na-vmro-dpmne-da-izlezat-od-pritvor), 5 mars 2018. <http://www.press24.mk/reformskite-zakoni-usoglaseni-se-cheka-samo-pratenicite-na-vmro-dpmne-da-izlezat-od-pritvor>. (për herë të fundit qasur më 24.04.2018)

Informacione shtesë

Informacione për projektin

Monitorimi i implementimit të masave nga Plani 3-6-9 të Qeverisë është pjesë e projektit Perform on Reform – Përcjelle e procesit reformues, të Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSC) në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer.

Informacione për IDSCS

IDSCS është tink tenk organizatë civile e cila e hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e të drejtës dhe integritet evropiane të Maqedonisë. IDSCS ka mision që ta ndihmojë inkluzionin qytetar në vendimmarrjen dhe ta përforcojë kulturën pjesëmarrëse politike. Përmes fuqizimit të vlerave liridashëse, IDSCS kontribuon për bashkëjetesë midis dallimeve.

Informacione për KAS

Liria, drejtësia dhe solidariteti janë principet që orientojnë punën e Fondacionit-Konrad-Adenauer (KAS). KAS është një fondacion politik, i cili i qëndron pranë Unionit Kristian-Demokrat të Gjermanisë. Ne realizojmë programe edukimi për shoqërinë dhe bashkëpunojmë me institucionet qeveritare, partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe elita të zgjedhura, duke ndërtuar partneritete të forta përgjatë rrugës. Së bashku me partnerët tanë ne kontribuojmë në krijimin e një rendi ndërkombëtar që i mundëson çdo vendi të zhvillohet në liri dhe nën përgjegjësinë e tij.

Informacione për autorin

Zoran Neçev është hulumtues më i vjetër dhe udhëheqës i Qendrës për integritet evropiane pranë IDSCS. Fushat e interesimit akademik dhe profesional të Zoran Neçevit janë zgjerimi i UE, evropizmi, politika e kushtëzimit, Ballkani Perëndimor, drejtësia dhe punët e brendshme.

Ivan Nikolovski është hulumtues më i ri në Qendrën për integritet evropiane pranë IDSCS. Nikolovski është Master në shkencat politike me specializim në politikën krahasuese. Interesat e tij akademike dhe profesionale janë shoqëri të ndara, integritet evropiane dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Linku

Ky raport është i qasshëm në version elektronik në <http://idscs.org.mk/mk/2018/04/24/извештај-од-набљудување-на-спроведув-2/>

Kontakt informacione për IDSCS

Adresa: rr. Teodosij Golloganov nr. 42A/3 dhe 42A/4, 1000 Shkup
Numri i telefonit/faksi: +389 2 3094 760
Posta elektronike: contact@idscs.org.mk

Kontakt informacione për KAS

Adresa: Risto Ravanovski nr. 8, 1000 Shkup
Numri i telefonit/faksi: +389 2 321 70 75
+389 23 21 70 76
Posta elektronike: Skopje@kas.de

**GARË NË 3, 6 DHE 9 ME PENGESA.
REKOMANDIMI ËSHTË SIGURUAR,
ÇKA NË TË ARDHME?**

Monitorimi i zbatimit të tre muajve
të fundit nga Plani 3-6-9

Maj 2018

